



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:199879
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05532788

Ac.nr.2945/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehollli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B , të cilin e përfaqëson me autorizim avokati F.M, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S”, të cilën me autorizim e përfaqëson S.D, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.404/19 e datës 23.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S” dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.404/19 e datës 23.02.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin ankimor C.nr.404/19 e datës 23.02.2021, ka vendosur si vijon:

APROVOHET NE TERESI SI E BAZUAR kërkesë padia e paditësit A.B.

I. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “ S”, që paditësit A.B, në emër të kompensimit të dëmit , për aksidentin e datës 27.11.2016, nga baza e autipërgjegjësisë, ti paguaj për automjetin e dëmtuar shumë prej 733 euro.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S”, me seli në Prishtinë, që shumën e gjykuara, si në pikën I, në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ti paguaj me kamatë ligjore sipas normës 8% , nga dita e parashtrimit të padisë (10.09.2019), e të gjitha këto ti përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “ S”, që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 969 euro, e të gjitha këto, ti përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimi ankimor të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje meritore.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur i autorizuari i paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A.B, përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S”, për kompensim dëmi, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke arsyetuar se në bazë të aktgjykimit penal të kësaj gjykate është vërtetuar se i siguruari i të paditurës është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit për shkaktimin e aksidentit ndërsa me ekspertizën e makinerisë është vërtetuar lartësia e dëmit në automjet në shumë prej 733.00 euro. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 136.1, 140, 159.1, 169, 170 dhe nenit 382 të LMD-së dhe nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë sepse me provat e administruara dhe atë nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore Pejë–Dega Istog, P.nr. 233/17, i dt.18.10.2017 i cili është i formës së prerë me dt.13.11.2017, është vërtetuar si i siguruari i të paditurës është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit dhe atë mbi bazën e pranimit të fajësisë, po ashtu edhe me ekspertizën e

komunikacionit të punuar nga eksperti K.R është vërtetuar se deri te aksidentit ka ardhur si rezultat i lëshimeve të siguruarit të paditurës, me të cilat prova në mënyrë bindëse vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë, ndërsa gjykata e shkallës së parë me të drejt ka vepruar kur nuk e ka marr për bazë ekspertizën e komunikacionit e punuar nga eksperti S.B për arsye se nuk ishte bindëse dhe ishte në kundërshtim me aktgjykimin penal si dhe me ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti K.R, të cilin qëndrim e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e shkallë së parë e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës së makinerisë të punuar nga eksperti A.K i cili e ka vërtetuar demin material në automjet në lartësi prej 733.00euro. Sipas nenit 7.1 të LPK-së është paraparë: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*, ndërsa neni 319.1 të po këtij ligji ka paraparë: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta* ndërsa neni 322.3 i po këtij ligji ka paraparë: *Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.*

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i të paditurës edhe sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, për arsye se baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 136, 140, nenin 159 paragraf 1 dhe nenin 169 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi nga data 20 Dhjetor 2012. Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

I drejtë del te jetë edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, pasi që shpenzimet e njohura janë në përputhje të plotë me shpenzimet që i njëjti i ka pasur rreth përfaqësimit të paditurve në procedurë dhe kanë qenë të nevojshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

Ac.nr.2945/21, me datë 25.03.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku